

KONKURS DIZAJNI GRAFIK

Dizenjimi i Logos & Visual Brand Identity

për Bashkimin e Prodhuesve Shqiptarë (BPSH)

Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë, në bashkëpunim me Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, Universiteti Politeknik i Tiranës dhe Departamentin e Tekstilit dhe Modës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Universiteti Politeknik i Tiranës, ka kënaqësinë të shpallë këtë **Konkurs Dizajni Grafik**, drejtuar studentëve, duke i ftuar ata të paraqesin propozime për dizajnin e logos së **Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë**.

1. Hyrje & Qëllimi

Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë, është një organizatë që mbështet prodhimin vendas, duke synuar zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në Shqipëri përmes ofrimit të shërbimeve të integruara për kompanitë më të mëdha prodhuese në territorin e Republikës së Shqipërisë. Organizata përfaqëson mbi 50 anëtarë aktivë, mbi 500 bashkëpunëtorë nga sektorët më poshtë: Prodhimi i Ushqimit dhe Pijeve; Industria përpunuese; Industria e prodhimit dhe përpunimit të materialeve të ndërtimit; Industria e riciklimit dhe përpunimit të metaleve, plastikës, letrës, kartonit dhe drurit.

Në kuadër të përcaktimit të saj institucional, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë, në bashkëpunim me Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, Universiteti Politeknik i Tiranës dhe Departamentin e Tekstilit dhe Modës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Universiteti Politeknik i Tiranës shpall këtë Thirrje për Shprehje Interesi drejtuar studentëve, me qëllim angazhimin e dizajnerëve të rinj, përmes nxitjes së kreativitetit dhe inovacionit, duke u dhënë studentëve mundësinë të kontribuojnë në zhvillimin e *brandimit* të një institucioni me rëndësi strategjike për zhvillimin e vendit.

2. Objekti i Thirrjes

Pjesëmarrësit ftohen të paraqesin një propozim dizajni për *brandimin* e Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë, i cili duhet të përfshijë:

1. Koncept- idenë e Logos
2. Logo përfundimtare
3. *Visual Identity*
4. Aplikime të Thjeshta

Koncepti i propozuar duhet të pasqyrojë misionin, vlerat dhe mandatin e Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë si institucion kombëtar zhvillimi.

3. Udhëzime Kryesore Konceptuale

Koncepti i dizajnit duhet të reflektojë qartësisht idetë kryesore:

1. Industri e fortë dhe konkurruese
2. Inovacion dhe modernizim
3. Besueshmëri dhe përfaqësim institucional
4. Zhvillim i qëndrueshëm dhe vizion afatgjatë

Qasja e propozuar e dizajnit duhet të marrë në konsideratë praktikatat më të mira të organizatave të biznesit që operojnë në nivel ndërkombëtar në të njëjtën fushë, duke ruajtur njëkohësisht origjinalitetin.

4. Përshatshmëria

Kjo Thirrje është e hapur për:

- Studentë të të gjitha programeve të studimit në fushat e Dizajnit, Arkitekturës dhe Arteve, brenda dhe jashtë vendit, si dhe ish-studentëve të diplomuar në tre vitet e fundit.

Pjesëmarrja mund të jetë:

- Individuale, ose
- Në grup (maksimumi 3 persona)

Çdo pjesëmarrës ose grup mund të paraqesë vetëm një propozim.

5. Materialet për tu dorëzuar

Çdo propozim duhet të përfshijë komponentët e mëposhtëm:

5.1. Dizenjimi i Logos

- 5.1.1. Propozimi origjinal dhe i pabotuar i logos;
- 5.1.2. Shpjegim i qartë konceptual i dizajnit;
- 5.1.3. Versione të logos me ngjyra, bardh e zi dhe monokrom;
- 5.1.4. Informacion mbi shkallëzueshmërinë dhe lexueshmërinë e logos.

5.2. *Visual Identity*:

- 5.2.1. Koncept *Brand-book*;
- 5.2.2. Paletën e ngjyrave (ngjyra primare dhe sekondare);
- 5.2.3. Tipografinë (fontet primare dhe sekondare);

5.3. Aplikime të Thjeshta (*Mock-up Konceptuale*)

- 5.3.1. Kartëvizitë;
- 5.3.2. Kokë- shkrese;
- 5.3.3. Media Sociale
- 5.3.4. *Cover* prezantimi;

5.3.5. *Merchandise*

5.3.6. Aplikime në shkallë të ndryshme.

6. **Formati i Dorëzimit**

Propozimet duhet të **dorëzohen** në format digjital dhe të përfshijnë:

1. Një dokument të vetëm PDF që përmban të gjithë elementët e kërkuar;
2. Materiale vizuale të strukturuar dhe të etiketuara qartësisht;
3. Një tekst të shkurtër konceptual që shpjegon arsyetimin e dizajnit.
4. Fituesi do të dorëzojë gjithashtu versionin e editueshëm të logos dhe *brand book*-ut.

Në brendësi dokumenti do të jetë i strukturuar në një poster A1 dhe brand-book në format A4 (kompozimi i dokumenteve është i lirë).

Dokumenti do të jetë anonim dhe do të emërtohet me një kod identifikimi të ekipit projektues. Kodi i identifikimit të projektit do të jetë një numër 5 shifror, i cili do të propozohet nga vetë aplikanti apo grupi i projektimit, në momentin e dorëzimit të materialit për konkurs. Kodi duhet të jetë në emërtimin e file-it si dhe në brendësi të dokumentit.

Nuk do të pranohen aplikimet me elemente të tjera identifikuese.

Propozimi duhet të jetë i shkruar në SHQIP dhe jo më shumë se 300 fjalë brenda posterit A1. Propozimi mund të bëhet me teknikën e zgjedhur nga kandidatët (diagrame, skica, kolazhe, vizatime CAD, etj.).

Prezantimi:

Propozimi duhet të paraqitet në formë prezantimi vizual, të strukturuar qartësisht, në një ose disa faqe/poster dixhital, ku të ilustron koncepti i logos, zhvillimi grafik dhe aplikimet kryesore. Prezantimi duhet të përfshijë paraqitjen e logos në kontekste të ndryshme (mock-up), në mënyrë që të demonstron qartë funksionalitetin, përshtatshmërinë dhe koherencën vizuale të identitetit të propozuar. Materialet duhet të jenë të organizuara në mënyrë profesionale dhe të lehta për t'u kuptuar nga Komisioni i Vlerësimit.

7. **Afatet**

Publikimi i Thirrjes: 24 Prill 2026

Afati i Regjistrimit: 30 Prill 2026

Regjistrimi bëhet në Google Form - <https://forms.gle/ZQ1vVzbdYT8H4PLX9>

Afati i Dorëzimit fillestar: 7 Maj 2026

Dorëzimi bëhet në Google Form - <https://forms.gle/cQJ7GB1NDEcf7sXs8>

Njoftimi i short-list: 8 Maj 2026

Ceremonia e Prezantimit dhe Përzgjedhja: 12 Maj 2026 (Aula Magna UPT)
Dorëzimi i brand-book të plotë nga fituesit: 22 Maj 2026

8. Procesi i Vlerësimit

Të gjitha propozimet do të vlerësohen nga një Komision i Përbashkët Vlerësimi, i përbërë nga:

1. Përfaqësues të Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë;
2. Staf akademik nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Universiteti Politeknik i Tiranës dhe Departamenti i Tekstilit dhe Modës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Universiteti Politeknik i Tiranës.

Kriteret e vlerësimit përfshijnë:

1. Arsytimi konceptual dhe origjinalitetin;
2. Përputhshmërinë me misionin dhe vlerat e Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë
3. Cilësinë vizuale dhe koherencën;
4. Aplikueshmërinë praktike dhe shkallëzueshmërinë e dizajnit;
5. Prezantimin profesional të propozimit.

9. Çmimi

Konkursi do të shpallë dy çmime. Çmimet do t'u jepen fituesve sipas vendeve:

- Vendi i parë – 800 €
- Vendi i dytë – 400 €

Propozimi i renditur i pari nga Komisioni i Vlerësimit do të ftohet të zhvillojë dokumentin e plotë të *brand-book* brenda një afati 15 ditor nga data e shpalljes.

Ceremonia e ndarjes së çmimit do të zhvillohet më 8 Maj 2026, në ambientet e Universitetit Politeknik të Tiranës.

10. Të Drejtat e Pronësisë Intellektuale

Autorët e propozimit të përzgjedhur do të njihen si krijuesit e dizajnit.

Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë do të fitojë të drejtën për të përdorur, përshtatur dhe zhvilluar më tej identitetin vizual të përzgjedhur për qëllime institucionale.

Propozimet e papërzgjedhura mbeten pronë intelektuale e autorëve përkatës.